



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 16, Datë 26.01.2026

MBI

PEZULLIMIN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “PROSOL” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 66, pika 1, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.01.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 142/1 prot., datë 21.01.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “PROSOL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2609 prot., datë 10.10.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapaciteti 21 MW. Vendndodhja e centralit është në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 259, datë 21.10.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.10.2025 dhe 23.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.11.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedurë, nëpërmjet shkresës nr. 2609/3 prot., datë 27.10.2025, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.
- Me shkresën nr. 2609/5 prot., datë 21.10.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka njoftuar për zhvillimin e një seancë dëgjimore me qëllim sqarimin e informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit.
- Në vijim të sqarimeve të dhëna në seancë, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2609/8 prot., datë 20.11.2025, me nr. 2609/10 prot., datë 27.11.2025 dhe nr. 2609/12 prot., datë 12.12.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit, si dhe ka paraqitur një argumentim teknik në lidhje me kapacitetin e centralit, ku 21 MWp që konvertohet në 20

MW AC. Po ashtu, ka depozituar shkresën e saj të datës 16.12.2025, drejtuar MIE-s, për dijeni ERE, të protokolluar në ERE me nr. 2609/13 prot., datë 18.12.2025, me anë të së cilës ka kërkuar sqarimin përkatës në lidhje me fuqinë e instaluar të centralit fotovoltaik.

- Në vijim të sa më sipër, bordi i ERE-s me vendimin nr. 339, datë 23.12.2025, vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së kërkesës së shoqërisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kushtin që shoqëria brenda datës 13.01.2026, të depozitojë në ERE përgjigjen e MIE-s për shkresën e sipërcituar, si dhe raportimet periodike të depozituara në ministri, në kuadër të zhvillimit të projektit. Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 2609/15 prot., datë 29.12.2025.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 142 prot., datë 13.01.2026, shoqëria ka dokumentuar raportet periodike që ajo ka depozituar në MIE, në kuadër të ecures së zhvillimit të projektit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit dhe ka njoftuar se nuk ka ende një përgjigje nga MIE në lidhje me sa kërkuar nga ana e saj për fuqinë e instaluar të projektit, ose një pëlqim/miratim të fuqisë së aplikuar në ERE sipas shtojcës nr. 2 (21MW (20 MW AC)), ndaj ka kërkuar që ERE të marrë në konsideratë kërkesën për licencim të shoqërisë, duke qenë se në asnjë rast fuqia e instaluar e projektit nuk është tejkaluar, ose pezullimin e afatit të vendimmarrjes deri në plotësimin e dokumentit të munguar.

Zgjatja e vendimmarrjes së bordit

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet se: *nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.*
- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, parashikohet se bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.
- Për sa parashtruar e kërkuar nga vetë shoqëria, referuar dhe parashikimeve të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, duke qenë se marrja e një përgjigjeje/qëndrimi nga ana e MIE-s konsiderohet e rëndësishme për këtë procedurë, vlerësohet pezullimi i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 21 MW, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, deri në depozitim në ERE të përgjigjes/qëndrimit të MIE-s për kërkesën e bërë nga shoqëria në lidhje me kapacitetin e instaluar të centralit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, deri në depozitim nga ana e shoqërisë të përgjigjes/qëndrimit të Ministrisë së

Infrastrukturës dhe Energjisë për kërkesën e bërë nga ana e saj në lidhje me saktësimin e kapacitetit të instaluar të centralit fotovoltaik

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE me depozitimin nga e shoqërisë të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “PROSOL” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI